


Puna e mësuesit për zhvillimin e kompetencës fonologjike

Rimat, ashtu siç i njeh çdo kulturë, janë më të rëndësishme për zhvillimin gjuhësor sesa që mund të duket në shikim të parë. Nëpërmjet të kësaj ndihmojnë për zhvillimin e shqiptimit, leksikut dhe strukturave gjuhësore. Formimi i kompetencës fonologjike luan një rol të madh në zhvillimin e kompetencës së komunikuese të nxënësve pasi merret me formimin e njëpasnjëshëm dhe të qëllimshëm të bazave të shqiptimit të secilit lloj të veprimtarisë së të folurit. Mësuesi mund të zhvillojë një sistem ushtrimesh i cili ndihmon në formimin e kompetencës fonologjike. Sistemi i zhvilluar i mësimdhënies së kompetencave fonologjike lejon realizimin e përqasjes fazore të formimit të secilës përbërës të kompetencës fonologjike në llojet e tjera të veprimtarisë së të folurit: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit.

Rimimi një mënyrë e shkëlqyeshme që të mësohet leximi është të dëgjohen dhe të shqiptohen rima. Këmbimi i rimave me fëmijët e vegjël u ndihmon atyre që t'i dëgjojnë skemat e gjuhës. Fëmijët së pari fillojnë t'i dallojnë disa fjalë që i kanë tingujt e njëjtë edhe në fund (rimimi). Pastaj vërejnë se shumë fjalë shkruhen ngjashëm. Kuptimi i këtyre lidhjeve e lehtëson dukshëm procesin e mësimin të leximit. Ju si mësues mund të ndihmoni atë që do t'u mundësoni fëmijëve të dëgjojnë shumë rima. Rima që mund të gjendet në poezi po ashtu mund të ndihmojë, sepse krijon ritëm në lexim.

- Këndoni këngë për fëmijë dhe bëni ato më argëtuese, duke shtuar aktivitete dhe lëvizje me trup.
- Lexoni përralla që rimohen.
- Luani lojë si “Në shkronjën pashë diçka që rimohet me.....”



<https://drive.google.com/file/d/13FBpA-7NA2x3kIi1DTRwnEjy5SwetwGg/view?fbclid=IwAR2QXEDfu2mVyUfJv0Gqdm2OCFjlzkwrijvQd7xIU3WlrucAW6Sp3G6aFMMP>

Në bazë të orës së dëgjuar nxiten fëmijët të krijojnë fjalë që rimojnë me fjalën **hëna**:

hëna: nëna, mëma, rrënja, qendra, ëndrra, nënta, zënka, qënka, ëndja, mbrëmja etj.

Mbi këtë bazë mësuesi punon edhe me fjalë të tjera. Fillon me fjalë që janë afër botës së fëmijëve për të kaluar në koncepte abstrakte. Në këtë pikë ndihmon edhe mësuesi p.sh.:

kukull: kungull-busull- uthull etj.

Makina: Dafina, Sabina,

Bukur: flutur, mbushur, ulur,

Tavolina: aspirina, Argjentina, limuzina, jasemina

Nga fjalë të veçanta mund të kalohet në tekste, si përralla apo poezi. Në këtë rast mund të sugjerohet një poezi për të parë se si rimojnë fjalët.

Mos thuej rrena kurr, o f' mi,
por gjithmonë duhet më ni.
Nji ndeshkim asht fort ma mirë,
Se rrencak ndokush me te thirrë.

Mos t' shkojë mendja se me rrena
Fajin tand e msheh përmbrenda
S' vonon dita e gja s' e ndal,
E' në fushë rrena ka me dalë.

Por veç marrja ka me t' mbetë
E kund besë nuk ke për t' gjetë.
Edhe t' drejtën n' kjoftë se e thue
Për rrencak kanë me t' kujtue.

(Ndre Mjedja)

Mësuesi veçon fjalët që rimojnë dhe punon me to. Fjalën mund ta kthejë në standard dhe punon mbi këtë bazë. Fjala e parë që rimon është emri **fëmijë**. Mësuesi kërkon nga nxënësit që të gjejnë fjalë që rimojnë brenda poezisë dhe jashtë saj, p.sh.:

fëmijë: shkëndijë, bijë, njëmijë, përfshijë, linjë etj.

Mirë: brirë, shkrirë, ngrirë, nxirë, mpirë, lirë, fshirë, shirë

Kalohet në fjalë më të vështira, nga ato dyrrrokëshe në trerrokëshe duke e rritur shkallën e vështirësisë:

Mirë: mugëtirë, butësirë, kushërirë, vogëlsirë, errësirë, shkretëtirë, lagështirë, egërsirë, erëmirë, zemërmirë etj.

Në këtë mënyrë punohet me secilën prej fjalëve.

Përdorini site të cilat ju lehtësojnë punën ju dhe prindit në shtëpi.

<https://sq.azrhymes.com/?rima=mesojme>

Për të zhvilluar kompetencën fonologjike mësuesit mund të konsultohet edhe me site didaktike të gjuhëve të tjera.

Më poshtë rekomandojmë:



https://www.youtube.com/watch?v=JHroOYO1iOo&t=94s&ab_channel=HarryKindergartenMusic